

# Gratë dhe Priftëria

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



“Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndihmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është dhuruar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. ... Një njeri mund të

ketë autoritet të dhënë atij ose një motër [autoritet] të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin, dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç’janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, *Relief Society Magazine*, janar 1959, f. 4].

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: ‘Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju’. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndihmës ‘i

[është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishme. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor.’ Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndihmës, Presidenti Smith shpjegoi: ‘[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishme ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve, duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, f. 4–5]. ...

Ne nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj” (“Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 51).

# Gratë dhe Priftëria

Plaku Dallin H. Ouks, i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha:



“Në një fjalim drejtuar Shoqatës së Ndihmës, Presidenti Jozef Filding Smith, në atë kohë Presidenti i Kuorumit të Dymbëdhjetë Apostujve, tha këtë: Ndërsa motrave nuk iu është dhënë Priftëria, nuk iu është dhuruar atyre, kjo nuk do të thotë se Zoti nuk u ka dhënë atyre autoritet. ... Një njeri mund të

ketë autoritet të dhënë atij ose një motër [autoritet] të dhënë asaj, për të bërë gjëra të caktuara në Kishë, të cilat janë lidhëse dhe tërësisht të nevojshme për shpëtimin tonë, siç është puna që motrat tona bëjnë në Shtëpinë e Zotit. Ato kanë autoritet të dhënë atyre për të bërë disa gjëra të mëdha dhe të mrekullueshme, të shenjta për Zotin, dhe lidhëse, në mënyrë po aq tërësore sa ç’janë bekimet që jepen nga burrat që mbajnë Priftërinë’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, *Relief Society Magazine*, janar 1959, f. 4].

Në atë fjalim të shquar, Presidenti Smith tha në mënyrë të përsëritur se grave u është dhënë autoritet. Grave ai u tha: ‘Ju mund të flisni me autoritet, sepse Zoti ka vendosur autoritet mbi ju’. Ai gjithashtu tha se Shoqatës së Ndihmës ‘i

[është] dhënë fuqi dhe autoritet për të bërë shumë gjëra të madhërishme. Puna që ato bëjnë, bëhet nëpërmjet autoritetit hyjnor.’ Dhe, sigurisht, puna e Kishës, e bërë nga burra ose gra, qoftë në tempull apo në lagjet ose degët, bëhet nën drejtimin e atyre që mbajnë çelësa të priftërisë. Kështu, duke folur për Shoqatën e Ndihmës, Presidenti Smith shpjegoi: ‘[Zoti] ua ka dhënë atyre këtë organizatë të madhërishme ku ato kanë autoritet për të shërbyer nën drejtimin e peshkopëve të lagjeve, duke u kujdesur për interesin e njerëzve tanë si shpirtërisht ashtu dhe materialisht’ [‘Relief Society – An Aid to the Priesthood’, f. 4–5]. ...

Ne nuk e kemi zakon të flasim për gratë që të kenë autoritetin e priftërisë në thirrjet e tyre në Kishë, por çfarë autoriteti tjetër mund të jetë ai? Kur një grua – e re apo e moshuar – veçohet për të predikuar ungjillin si një misionare kohëplotë, asaj i jepet autoritet priftërie për të kryer një funksion priftërie. E njëjta gjë është e vërtetë kur një grua veçohet për të vepruar si nëpunëse ose mësuese në një organizatë të Kishës, nën drejtimin e një personi që mban çelësat e priftërisë. Kushdo që vepron në një detyrë ose thirrje të marrë nga një njeri që mban çelësat e priftërisë, ushtron autoritet priftërie në kryerjen e detyrave të caktuara atij ose asaj” (“Çelësat dhe Autoriteti i Priftërisë”, *Ensign* ose *Liahona*, maj 2014, f. 51).

